



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2372/2 prot

Datë 02.12.2021

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Anakonda Security” SHPK & “Oktapus Security” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-07782-10-11-2021 me objekt “*Shoqërimi dhe sigurimi i vlerave monetare të FSHU sh.a Rajoni Tiranë për një periudhë 2 vjeçare*”, me fond limit 55,454,452.83 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.11.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Tiranë.

Ankimues: BOE “Anakonda Security” SHPK & “Oktapus Security” SHPK
Adresa: L. “15 Shtatori”, banesë 1-katëshe, nr.32, Tepelenë.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria Rajonale e OSSH Tiranë
Adresa: Rr. “Reshit Petrela”, përballë Dispanserisë, Tiranë.

Në datën 01.12.2021 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 2372 e BOE “Anakonda Security” SHPK & “Oktapus Security” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-07782-10-11-2021 me objekt “*Shoqërimi dhe sigurimi i vlerave monetare të FSHU sh.a Rajoni Tiranë për një periudhë 2 vjeçare*”, me fond limit 55,454,452.83 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.11.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Anakonda Security” SHPK & “Oktapus Security” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a)*

ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që ankimesi BOE “Anakonda Security” SHPK & “Oktapus Security” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2372 prot., datë 01.12.2021.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“1. Anetari i BOE Oktapus Security nuk ploteson kërkesen e dhene ne DST Shtojca 8 e modifikuar, Kapaciteti Teknik: pika 2.3.7 pasi ne Formularin Permbledhes te Deklarimit sipas Shtojces Nr.9 te DST-se nuk eshte pasqyruar disponimi i mjeteve te kerkuara te blinduara me te gjithë dokumentacionin e cituar me te dhenat konkrete;

→ (Autorizim te posacem vjetor nga Drejtori i Pergjithshem i Policise se Shtetit per perdorim te cdo mjeti te blinduar (te vlefshem per vitin 2021 e ne vazhdim), ku te jene percaktuar emri i shoqerise, te dhenat e mjetit dhe afati i vlefshmerise,

→ Certificate pronesie, → Leje qarkullimi nga Drejtoria e Transportit Rrugor per cdo mjet, → Leje drejtimi te perdoruesit te mjetit te blinduar,

→ Certificate e kontrollit teknik per secilin mjet (SGS), → Siguracion te vlefshem,

→ Vertetim per taksat e paguara).

2. Anetari i BOE Oktapus Security nuk ploteson kërkesen e dhene ne DST Shtojca 8 e modifikuar, 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Pika 2.2.3 pasi vertetimi i taksave leshuar nga Bashkia Tirane ne daten 19.10.2021 nuk shprehet per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2021. Anetari Oktapus Security nuk ploteson kërkesen e dhene ne DST Shtojca 8 e modifikuar, 2.3 Kapaciteti Teknik: pika 2.3.4 pasi vertetimi i performances leshuar nga Drejtoria e Policise se Qarkut Tirane me nr. 168/241 prot. date 27.10.2021. Nuk ka te pasqyruar GPS sipas kërkeses se AK. Gjithashtu ne kete vertetim eshte pasqyruar dhenia e mases administrative per 2021 Anetari i BOE Oktapus Security nuk ploteson kërkesen e dhene ne DST Shtojca 8 e modifikuar, 2.3 Kapaciteti Teknik: pika 2.3.8 pasi nuk ka paraqitur certificate te leshuar nga prodhuesi i mjetit te blinduar per normen e blindimit ku te referohet se automjetet e blinduara jane te Kategorise jo me te vogel se BR 4 sipas normes europiane UNI EN 1063. Mjetet e paraqitura nga ky Operator nuk shprehen per normen e blindimit jo me te vogel BR 4 sipas normes europiane UNI EN 1063.

3. Anetari i BOE Anakonda Security nuk ploteson kërkesen e dhene ne DST Shtojca 8 e modifikuar, Kapaciteti Teknik: pika 2.3.7 pasi ne Formularin Permbledhes te Deklarimit sipas Shtojces Nr.9 te DST-se nuk eshte pasqyruar disponimii mjeteve te kerkuara te blinduara me te gjithë dokumentacionin e cituar me te dhenat konkrete

4. → (Autorizim te posacem vjetor nga Drejtorii Pergjithshem i Policise se Shtetit per perdorim te cdo mjeti te blinduar (te vlefshem per vitin 2021 e ne vazhdim), ku te jene percaktuar emir i shoqerise, te dhenat e mjetit dhe afati ivlefshmerise,

→ Certificate pronesie.

→ Leje qarkullimi nga Drejtoria e Transportit Rrugor per cdo mjet.

→ Leje drejtimi te perdoruesit te mjetit te blinduar.

→ Certificate e kontrollit teknik per secilin mjet (SGS),

→ Siguracion te vlefshem.

→ Vertetim per taksat e paguara

6. Anetari i BOE Anakonda Security nuk ploteson kerkesen e dhene ne DST Shtojca 8 e modifikuar, 2.3 Kapaciteti Teknik pika 2.3.4 pasi vertetimi i performances leshuar nga Drejtoria e Policise se Qarkut Tirane me nr. 284/47 prot. date 28.10.2021.

- Nuk ka te pasqyruar GPS sipas kerkeses se AK. Anakonda Security nuk ploteson kerkesen e dhene ne DST Shtojca 8 e modifikuar, 2.3 Kapaciteti Teknik: pika 2.3.8 pasi certifikatat e leshuara nga prodhuesi i mjetit te blinduar nuk jane te sakta, origjinale ose kopje të noterizuara.

- Deklarata e dates 20.01.2016 Numri i shasisë Fiat Ducato Shasia nr. 5338302 Fiat Ducato Shasia nr. 5594554 Fiat Ducato Shasia nr. 5752801 Eshte fotokopje dhe i mungon Vertetim njesia me origjinalin nga ana e Noterit.

- Deklarata e pa date Numri i shasisë FIAT DUCATO: 7035239 Numri i shasisë FIAT DUCATO: 7033919 Numri i shasisë FIAT DUCATO: 7034930 eshte fotokopje dhe i mungon Vertetim njesia me origjinali nga ana e Noterit. Gjithashtu i mungon vula e perkthyesit per perkthimin nga gjuha italiane ne Shqip.

- Deklarata e dates 21.03.2016 Numri i shasisë Volksäagen ËVIZZZ7HZ6H088866 eshte fotokopje dhe i mungon Vertetim njesia me origjinalin nga ana e Noterit. Gjithashtu i mungon vula e perkthyesit per perkthimin nga gjuha italiane ne Shqip.

- Deklarata e dates 22.10.2018 Numri i shasisë Mercedes Sprinter ËDB9066311S387606 eshte fotokopje dhe i mungon Vertetim njesia me origjinalin nga ana e Noterit

Oferta ekonomike e bashkimit te operatoreve ekonomike nuk pranohet pasi disa nga zerat e kesaj oferte si lenda djegese, taksa mirembajtje dhe siguracione jane ne vleren 0, Per zerin taksa dhe siguracione ne referim te ligjit Nr. 9975 date 28.07.2008 i ndryshuar dhe Ligjit Nr 32/2021 nuk mund te vihen ne vleren 0. Ne keto kushte ne baze te nenit 82 te VKM per miratimin e rregullave te prokurimit publik, kjo oferte refuzohet”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 02.12.2021.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri